VENDIM
Nr. 505, datë 10.9.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 425, DATË 27.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME LICENCË PËR PROJEKTIM, ZBATIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM NË PASURITË KULTURORE, PËR KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE PUBLIKE NË PASURITË KULTURORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 22, e kreut II, të vendimit nr. 425, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"22. Oferta fituese përcaktohet sipas çmimit më të ulët ose sipas konceptit "oferta më e favorshme", duke u bazuar në kombinimin e elementeve teknike dhe ekonomike. Për vlerësimin e propozimeve teknike dhe ekonomike përdoren kritere dhe metoda të përcaktuara në dokumentet standarde të konkurrimit publik."

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, si dhe institucionet publike që kanë në administrim pasuri kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama